



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Nr. 8518 Prot.
28

Tiranë, më 12.07 2023

NJOFTIM

Z. GENTI MINAROLLI

Në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Pjesa VII, neni 162, dhe referuar faktit se z. Genti minarolli, nuk iu përgjigj shkresave të dërguara në adresën Rruga “Ali Demi”, Pallati nr. 261, Ap. 23, Tiranë, konkretisht:

- Shkresës së Departamentit të Administratës Publike nr. 2876/2, datë 13.06.2023, me subjekt “Akt emërimi”;
- Shkresës së Departamentit të Administratës Publike nr. 2876/3, datë 13.06.2023, me subjekt “Përcillet akti i emërimit për z. Genti Minarolli”;
- Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8518/19, datë 15.06.2023 me subjekt “Për fillimin e marrëdhënieve financiare të z. Genti Minarolli”.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë vendosi të kryejë njoftimin publik për z. Genti Minarolli, si vijon:

Në mbështetje të nenit 66/1, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Urdhrit nr. 5151, dt. 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, pikës 3, të Kreut VII, të VKM-së nr. 118/2014, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbim civil të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimit nr. 5286 (80-2015-3569), datë 22.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 5413, datë 20.12.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, jeni emëruar nëpunës civil në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria e pagës II-a”.

Marrëdhëniet financiare në këtë pozicion kanë filluar më date 19.06.2023, në zbatim të afateve ligjore dhe të shkresës së Departamentit të Administratës Publike nr. 2876/3, date 13.06.2023, me subjekt “Përcillet akti i emërimit për z. Genti Minarolli”.

Ju informojmë se ju mbartni detyrimin të paraqiteni në ambientet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, referuar faktit se marrëdhëniet tuaja të punës kanë filluar.

Për sa më lart, në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Pjesa VII, neni 162, ju informojmë se ky njoftim do të shpallet në :

- Këndin e posaçëm të njoftimeve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- Faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, www.financa.gov.al;
- Këndin e njoftimeve në Njësinë Bahskiake nr. 1, ku rezulton i regjistruar z. Minarolli;
- Faqen zyrtare elektronike të njësisë bashkiake ku rezulton I regjistruar z. Minarolli <https://tirana.al/njesia-administrative/njesia-nr-1>;
- Këndin e posaçëm të njoftimeve në Prefektin e Tiranës;
- Faqen zyrtare elektronike të Prefektit të Tiranës <http://prefektitirane.gov.al/>

Njoftimi shpallet sot më datë 12.07.2023 dhe hiqet më datë 22.07.2023.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Risana Xhaja

